REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
POLIÇAN

Nr. 2048 Prot

Poliçan më 12.08.2026

LËNDA: NJOFTIM PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Tema: Shqyrtimi i Draft-Propozimit për Reformën Administrativo-Territoriale dhe Ndikimi në Bashkinë Poliçan

Të nderuar Qytetarë!

Në mbështetje të nenit 18 pika 1 dhe 2, të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligjit 146, datë 30.10.2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", ju njoftojmë se Këshilli Bashkiak ka miratuar një kalendar të konsultimeve publike në të tre njësitë administrative, duke garantuar një proçes sa më të gjerë, transparent dhe gjithëpërfshirës.

Kalendar i konsultimit publik

Titulli i Projekt-aktit : Konsultimi me komunitetin për raportin të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale, si dhe në projektligjin "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".
Propozuesi : Projekt –akti është propozuar nga Këshilli Bashkiak Poliçan.

Sqarime për projekt-aktin : Ky konsultim organizohet për të diskutuar draft-propozimet e reja që lidhen me ndryshimet e mundshme të kufijve administrativë, efikasitetin e shërbimeve vendore dhe menaxhimin e territorit pas reformës së propozuar.

Grupet që do të konsultohen: Këshilli Bashkiak i Bashkisë Poliçan, në përmbushje të detyrimeve ligjore për transparencë dhe përfshirje qytetare në vendimmarrje, njofton të gjithë banorët, përfaqësuesit e bizneseve, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat, për zhvillimin e seancës së **Konsultimit Publik**.

Nr	Njësisë Administrative	Data	Vendi	Ora	Mënyra	Forma
1-	Konsultim publik me Njësinë Administrative Vërtop	18.08.2026	Godina e Njësisë Administrative Vërtop Kati i parë	10:00	Takim publik	Bisedë
2-	Konsultim publik me Njësinë Administrative Tërpan	19.08.2026	Qëndra Kulturore Kati, dytë Poliçan	10:00	Takim publik	Bisedë
3-	Konsultim publik me Njësinë Administrative Poliçan	20.08.2026	Qëndra Kulturore Kati, dytë Poliçan	10:00	Takim publik	Bisedë

Pjesëmarrja juaj është e një rëndësie të veçantë për garantimin e një procesi sa me transparent dhe gjithëpërfshirës, për të mbrojtur interesat e komunitetit tonë dhe për të garantuar shërbime më të mira publike!

Duke ju falenderuar,

KRYETARE E KËSHILLIT
Mimoza Lulaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POLIÇAN

Adresa: Lagjia "Qender" Poliçan ; Tel: 0368 2 4200 ; Email: njvbashkiapolican@gmail.com